

**NJOFTIM**

Për: Z/Znj. \_\_\_\_\_ (Aksioner/Perfaqesues/e i/eAksionerit \_\_\_\_\_)

Per ndryshimin e rendit te ditës te mbledhjes se Asamblesë se Aksionareve date 08 Qershor 2024, sipas kërkesës se paraqitur nga Drejtoria ne përputhje me Nenin 139 «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare». Pas kësaj kërkesë, rendi i ditës se mbledhjes date 08 Qershor 2024 behet si me poshtë:

1. Mbi miratimin e Buxhetit te shoqërisë “Banka Credins” Sh.a për vitin 2024 përgatitur sipas IFRS dhe Metodologjisë se Raportimit te Bankës se Shqipërisë.
2. Mbi miratimin e Plan Biznesit te Bankës Credins sh.a për vitin 2024.
3. Mbi miratimin miratimin e emetimit te ri te obligacioneve afatgjate të konvertueshme në aksione të zakonshme te Bankes Credins sh.a.
4. Mbi riemërimin e anëtares te Këshillit Drejtues te Banka Credins sh.a. Znj. Raimonda Duka.
5. Mbi emerimin e Znj. Raimonda Duka anetare te Komitetit te Kontrollit te Bankës Credins sh.a.
6. Mbi miratimin e rritjes se shperblimit te anëtarëve te Komitetit te Kontrollit te Bankës Credins sh.a.
7. Mbi dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti ne mbledhjen e Asamblesë se Përgjithshme te Jashtëzakonshme te Aksionareve te Shoqërisë Credins Invest sh.a. Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive qe do te zhvillohet me rend dite si me poshtë:
  1. Mbi miratimin e pasqyrave financiare dhe raportit të audituesit të pavarur, të shoqërisë administruese Credins Invest sh.a., të Fondit të Pensionit “Credins Pension”, të Fondit të Investimit “Credins Premium”, të Fondit “Sea Land Alternative Investment Fund” Shoqëri Komandite SIK, të Fondit “Green View Alternative Investment Fund” Shoqëri Komandite SIK, për vitin e mbyllur më 31.12.2023.
  2. Mbi miratimin e shpërndarjes së rezultatit për vitin e mbyllur më 31.12.2023.
8. Mbi dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti ne mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë “Sea Land Alternative Investment Fund”, Shoqëri Komandite SIK qe eshte zhvilluar me rend dite sa me poshtë:
  1. Mbi miratimin e raportit të auditit të pavarur, si dhe pasqyrat financiare të Shoqërisë “Sea Land Alternative Investment Fund”, Shoqëri Komandite SIK për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi të paraqitur nga shoqëria e përzgjedhur audituese (ekspert kontabël i miratuar).
  2. Mbi miratimin e shpërndarjes së rezultatit të vitit ushtrimor 2023.
  3. Paraqitjen per dijeni te raportit vjetor te risqeve



9. Mbi dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti ne mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë “Green View Alternative Investment Fund”, Shoqëri Komandite SIK, qe eshte zhvilluar me rend dite sa me poshtë:

1. Mbi miratimin e raportit të auditit të pavarur, si dhe pasqyrat financiare të Shoqërisë “Green View Alternative Investment Fund”, Shoqëri Komandite SIK për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi të paraqitur nga shoqëria e përzgjedhur audituese (ekspert kontabël i miratuar).
2. Mbi miratimin e shpërndarjes së rezultatit të vitit ushtrimor 2023.
3. Paraqitjen per dijeni te raportit vjetor te risqeve

Jeni të lutur të paraqiteni. Ju Faleminderit.

**Maltin KORKUTI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**



Tirane me 29.03.2024



Sqarojmë se:

Referuar Statutit të shoqërisë dhe Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare» Aksionarët kanë këto të drejta dhe detyrime:

- Aksionarët, të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, mund t'u drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë, të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rend të ditës. Në kërkesë duhet të jepen arsyet dhe objektivat, si edhe çështjet për të cilat duhet të marrë vendime asambleja e përgjithshme. Nëse kërkesa nuk është pranuar, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë e përgjithshme e të vendosin çështje në rendin e ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 137 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare»
- Nëse asambleja e përgjithshme, në kundërshtim me sa më sipër, nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk përfshihet në rendin e ditës, secili prej aksionarëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:
  - a) të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse organet drejtuese nuk përmbushin kërkesat e tyre brenda 15 ditëve;
  - b) t'i kërkojnë shoqërisë blerjen e aksioneve të zotëruara prej tyre, sipas nenit 133 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare».
- Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, dhe thirrja u është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, në të njëjtat mënyra, me të cilat është kryer njoftimi i parë.
- Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një prokure nga një aksionar tjetër, apo nga një person i tretë.
- Administratorët dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.
- Prokura, mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.
- Asambleja merr vendimet nëpërmjet votimit të hapur.
- Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës apo administratorëve, asambleja e përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga aksionarët, të cilët zotërojnë një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
- Kopje të dokumentave dhe projekt-vendimeve bashkëlidhur me këtë njoftim do të gjeni edhe pranë Selisë së shoqërisë, nëpërmjet një kërkesë me shkrim të depozituar pranë shoqërisë "Credins Bank" sh.a.